

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Liridon Kastrati, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbllin Hetemi , U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë:17/0/2024
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	Nr. 020-435/13
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kamenicës	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 28717 për shfuqizimin e vendimit Nr. 21059 të datës 02.07.2024 për dhënien e pronës se palaujtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë

I miratuar më datë: 30.08.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 09.09.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 ka miratuar vendimin nr. 28717 për shfuqizimin e vendimit Nr. 21059 të datës 02.07.2024 për dhënien e pronës se palaujtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës është i bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 12.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kamenicës me datë 30.08.2024, me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim. Vendim nr. 28717 për shfuqizimin e pjesërishem të vendimit Nr. 21059 të datës 02.07.2024 bëhet me qëllim të *"harmonizimit të ligjshmërisë konform shkresës nr. 020-435/10 të datës 15.08.2024 të MAPL-së"*.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Kadri Rahimaj, gradonačelnik opštine Kamenica Liridon Kastrati, predsedavajući Skupštine opštine Kamenica
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a,
Od:	Erbilin Hetemi, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština / MALS Datuma, 17.09.2024 br. 020-435/13
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština
1.Službenik za potvrđivanje pravne procene:	
2.Službenik za izradu pravne procene	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kaminica
Vrsta odluke:	Odluka

Poštovani/a gradonačelnice,
Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 28717 o ukidanju Odluke br. 21059 od 02.07.2024.godine, o davanju na dugoročno korišćenje nepokretnosti opštine

Usvojena dana, 30.08.2024.godine,

Predložena na razmatranje u MALS-u dana: 09.09.2024

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Kamenica je na sednici održanoj 30.08.2024. godine, odobrila Odluku br. 28717 o ukidanju Odluke br. 21059 od 02.07.2024.godine, o davanju na dugoročno korišćenje nepokretnosti opštine.

MALS konstatuje da je doneta odluka od strane Skupštine opštine Kamenica zasnovana na Zakonu br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, član 12.

Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Kamenica dana, 30.08.2024.godine sa 23 glasa za, 0 protiv i 0 uzdržanih. Odluka br. 28717 o ukidanju Odluke br. 21059 od 02.07.2024.godine, o davanju na dugoročno korišćenje nepokretnosti opštine, sačinjena je radi „*usaglašavanja zakonitosti u skladu sa dopisom br. 020-435/10 od 15.08.2024.godine, od strane MALS-a*“.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
CENTRA PER SHERBIM TE QYTETIT
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 01 Nr. 28777
U. Br.

Nr. f. pag. 3 Data: 09/09
KAMENICEA 2024

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

IN-COMING
MINISTRIE E Pushtetit Lokal
MINISTRITVA Lokalnog Uprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data: 09.09.2024
Datum: 09.09.2024
Date:

Iqesia organizatije	Nr. i Lendes	Vlora
-VL	020-435/13	

Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 09.09.2024

Bazuar në nenet 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 1 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, nenit 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së Nr.020 – 435/10, dt. 15.08.2024 për Vendimin Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim të propozim-vendimit për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negociimit të ofertës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:30.08.2024 miratoi këtë:


VENDIM

- Me këtë Vendim bëhet shfuqizimi i pjesërishtëm i Vendimit Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negociimit të ofertës.
- SHFUQIZOHET** pika 1.2 nga Vendimi Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024, si në vijim:
 - Pika 1 paragrafi 1.2 (Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01372-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 4872 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës) të Vendimit Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negociimit të ofertës.
- Nga parcela e cekur në pikën 1.3 të vendimit bazë përkatësisht njësia kadastrale me nr. P-71107079-01371-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" jepen në shfrytëzim sipërfaqja prej 13183 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës, ndërsa sipërfaqja prej 19000 m² nga sipërfaqja e përgjithshme e njësisë kadastrale mbetet pronë komunale si në kopjen e planit që është në shtojcë të këtij vendimi.
- Mbetet në fuqi pjesa tjetër e Vendimit Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 Për miratim e vendimit për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negociimit të ofertës.
- Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa mbikëqyrjen për zbatimin e tij e bënë Kryetari i Komunës.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Vendimi Bazë Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për “Qëndresa Gagica Hajdari B.I”, me procedurë të negocimit të ofertës.
7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;
- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;
- MAPL-së; dhe
- Arkivit.



Arsyetim

Vendimi Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 për Dhënien e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim Afatgjatë përmes Procedurës së Negocimit, Në kuadër të detyrimeve tona për të siguruar përputhshmërinë e vendimeve të Komunës me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe në vijim të kërkesës dhe rekomandimeve të pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kemi shqyrtuar Vendimin Sh.01.Nr.21059 të dt. 02.07.2024 të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, me të cilin u miratua dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës së negocimit. Gjatë këtij procesi, është identifikuar se pika 1.2 e këtij vendimi nuk është në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Konkretisht, janë vërejtur këto mangësi:

Mospublikimi në Wefaqen Zyrtare të Komunës Parcela kadastrale nr. 71107079-01372-0 nuk është publikuar në listën e përgjithshme dhe të veçantë të pronave për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024 në webfaqen zyrtare të komunës, siç kërkohet nga neni 13 i Ligjit Nr. 06/L-092. Ky publikim është një kërkesë thelbësore për të garantuar transparencën dhe ligjshmërinë e procedurës së dhënies së pronës në shfrytëzim.

Mungesa e Harmonizimit me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor Parcela e përmendur nuk është argumentuar si në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) ose Hartën Zonale, gjë që është një kërkesë ligjore sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-092. Qëllimi i shfrytëzimit të pronës komunale duhet të jetë



DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. No. 020-435/10
Data. Datum. Date 15.08.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Liridon Kastrati, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 17/07/2024 Nr. 020-435
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kamenicës	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 21059 për dhënien e pronës së palaujtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës së negociimit
I miratuar më datë: 21.06.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.07.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit vlerëson se akti është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kamenicës me datën 21.06.2024 ka miratuar vendimin Nr. 21059 për dhënien e pronës se palaujtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës se negocimit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me të pranuar aktin e miratuar nga Kuvendi i Komunës të Kamenicës ka ndërmarr veprime bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale për shqyrtim të ligjshmërisë. MAPL ka identifikuar se lënda nuk është e kompletuar dhe për këtë arsye me datën 09.07.2024 verbalisht si dhe me datën 15.07.2024 në formë të shkruar ka kërkuar nga organet Komunës të Kamenicës të dërgojnë dëshmi se parcela kadastrale nr. 71107079-01372-0 është e publikuar në webfaqen zyrtare të komunës dhe se e njëta është në harmoni me PZHK ose Harten Zonale.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 81 *"shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë"* si dhe Rregullores nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 neni 5 *"pranimi të dokumenteve ose informacion shtesë nga organet Komunës të Kamenicës"* lidhur me vendimin Nr. 21059 për dhënien e pronës se palaujtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës se negocimit konstaton se:

Mospublikimi i parcelës kadastrale nr. 71107079-01372-0 në listën e pronave për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024 në webfaqen zyrtare të komunës si dhe mos argumentimi se është në *"harmonie me PZHK dhe Harten Zonale"* është në kundërshtim me Ligjin nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimin Nr. 21059 për dhënien e pronës se paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës se negocimit përkatësisht paragrafi 1.1 njësi kadastrale me nr. 71107079-01372 duke mos qenë i publikuar në webfaqen zyrtare të komunës është në kundërshtim me Ligjin nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 13 paragrafi 1 i cili ka përcaktuar se *"Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës. Parcela kadastrale nr. 71107079-01372-0 nuk është e publikuar në listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024 nga Komuna e Kamenicës dhe si e tillë nuk mund të ipet në shfrytëzim.*

Mosargumentimi se parcela kadastrale nr. 71107079-01372-0 është në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal ose Harten Zonale është në kundërshtim me Ligjin nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës neni 5 paragrafi 1.2 i cili ka përcaktuar se *"Qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme e komunës të jetë e harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor"*. Në rastin konkret parcela kadastrale nr. 71107079-01372-0 nuk është e argumentuar se është në harmoni me planifikimin hapësinor të komunës së Kamenicës.

Ministria e Admsinitimit të Pushtetit Lokal bazuar në të lartcekurat kërkon nga Kuvendi i Komunës të Kamenicës që të ndërmarrin veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtojë aktin të harmonizoj më legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Kadri Rahimaj, gradonačelnik opštine Kamenica Liridon Kastrati, predsedavajući Skupštine opštine Kamenica	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, vd. generalnog sekretara MALS-a,	
Od:	Erbiln Hetemi, vd. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS	Datuma: 17/07/2024 br. 020-435
Odgovorni službenici: 1. Službenik za potvrđivanje pravne procene: 2. Službenik za izradu pravne ocene	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština	
Lënda:	Zahtev za razmatranje zakonitosti akta opštine Kamenica	
Lloji i aktit:	Odluka	

Poštovani/a gradonačelnice,
Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 21059 o davanju nepokretnosti opštine na dugoročno korišćenje putem pregovaračkog postupka
Usvojena dana, 21.06.2023.god
Predložena na razmatranje u MALS dana, 02.07.2024.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da opštinski akt nije u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Štimlje je na održanoj sednici dana, 21.06.2024. godine usvojila donela Odluku br. 21059 o davanju nepokretnosti opštine na dugoročno korišćenje putem pregovaračkog postupka. Ministarstvo administracije lokalne samouprave je, prihvativši akt koji je usvojila Skupština opštine Kamenica, preduzela radnje na osnovu Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi radi razmatranja zakonitosti. MALS je utvrdilo da, predmet nije kompletan i iz tog razloga je dana 09.07.2024. godine, usmeno kao i 15.07.2024. godine, u pisanoj formi zatražila od organa Opštine Kamenica da dostave dokaze da je katastarska parcela br. 71107079-01372-0 objavljena na zvaničnom sajtu opštine i da je u skladu sa ORP ili Zonalnom kartom do 17.07.2024. godine.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave na osnovu Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, član 81 "obavezno razmatranje zakonitosti" kao i Uredba br. 06/2021 o izmeni-dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019 član 5 „Prijem dokumenata ili dodatnih informacija od strane organa Opštine Kamenica“ u vezi sa Odlukom br. 21059 o davanju nepokretnosti opštine na dugoročno korišćenje putem pregovaračkog postupka, konstatuje da:

Neobjavljivanje katastarske parcele br. 71107079-01372-0 u spisku imovine za davanje na korišćenje za 2024. godinu na zvaničnom sajtu opštine, kao i ne argumentiranje, da je u „usaglašenosti sa ORP i Zonalnom kartom“ je u suprotnosti sa Zakonom br. 06/l-092 odavanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine.

Odluka br. 21059 o davanju nepokretnosti opštine na dugoročno korišćenje putem pregovaračkog postupka, odnosno stava 1.1 k.j. 71107079-01372, koji nije ranije objavljen na zvaničnom sajtu opštine, je u suprotnosti sa Zakonom br. 06/l-092 o davanju na korišćenje i razmeni opštinske nepokretnosti, član 13 stav 1, kojim je određeno da „Opština treba objaviti opšti spisak nepokretnosti opštine, kao i poseban spisak nepokretnosti koje se planiraju dati na korišćenje za narednu godinu do 31. decembra, opravdavajući javni interes i privredni razvoj opštine. Katastarska parcela br. 71107079-01372-0 nije objavljen u opštem spisku nepokretnosti opštine, kao ni u posebnom spisku nepokretnosti koje opština Kamenica planira dati na korišćenje u 2024. godini, i kao takva ne može se dati na korišćenje.

Ne argumentovanje da je katastarska parcela br. 71107079-01372-0 u skladu sa razvojnim planom opštine ili zonskom kartom, je suprotnosti sa Zakonom br. 06/l-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, član 5 stav 1.2, kojim je utvrđeno da „Svrha korišćenja nepokretne imovine opštine mora biti usklađena sa prostorno planskim dokumentima“. U konkretnom slučaju, katastarska parcela br. 71107079-01372-0 nije argumenotvana da je u skladu sa prostornim planiranjem opštine Kamenica.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, na osnovu gore navedenog, zahteva od gradonačelnika opštine Kamenica preduzimanje radnji, i u zakonskom razmatranje i usklađenje akta sa zakonodavstvom na snazi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 02.07.2024

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARË
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

U. 01 Nr. 2/059
Br. 2/059

Data: 02/07
Datum: 02/07

Br. str. KAMENICËJA 2024

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING

Opština Kamenica
Municipality

Data: 02.07.2024
Datum: 02.07.2024

Nivelo organizativa	Nr. i Lendes	Vlora
-VI-	020-435	

Bazuar në nenet 12 dhe 14 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), nenin 11 të për dhënienë në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Qarkorën Ligjore për procedurën e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, neni 23 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nxjerr nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 10.08.2020, nenet 3 paragrafi 3.7, neni 5 paragrafi 5.1 shkronja h) dhe 38 paragrafi 38.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 datë 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 21.06.2024 miratoi këtë:

V E N D I M


Për miratim të propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë për "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", me procedurë të negociimit të ofertës

1. Me këtë vendim "Qëndresa Gagica Hajdari B.I" - (Cetifikata e Regjistrimit: 812163468), me përfaqësuese Qëndresa Gagica Hajdari nga Koretini, Komuna e Kamenicës, i IPET në shfrytëzim afatgjatë prej njëzetë (20) vitesh, pronat e paluajtshme të Komunës, sipas procedurës së negociimit.
 - 1.1. Njësia kadastrale me nr. P-71107079-00002-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 167132 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës. 2
 - 1.2. Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01372-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 4872 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës.
 - 1.3. Njësia kadastrale me nr. P-71107079-01371-0, vendi i quajtur, "Vijanski Rid" me sipërfaqe prej 32183 m², në zonën kadastrale në Çarakoc, Komuna e Kamenicës. 2
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale është realizimi i projektit "Ndërtimi i fermës së përzier" ashtu siç është përcaktuar në ofertën e negociuar. Investimi total duhet të arrijë 320,000.00 €, me rastin e funksionalizimit të projektit do të angazhohet plus katër (4) punëtorë nuk guxon të bëjë më poshtë në asnjë periudhë të secilit vit kalendarik pa koordinim dhe pajtim me Komunën e Kamenicës, prej momentit që "Qëndresa Gagica Hajdari B.I", fillon me kapacitet të plotë.

3. "Qëndresa Gagica Hajdari B.1" në emër të kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale do t'i paguaj Komunës qira vjetore në vlerë prej 1,160.00 € të qarkullimit vjetor nga Subjekti "Qëndresa Gagica Hajdari B.1", por jo më pak se çmimi i qirasë së tokës i përcaktuar me rregullore Komunale (EUR/vit).
4. Dhënia e pronës së paluajtshme komunale, edhe në këto raste evidentohet, në regjistrin e të drejtave pronësore.
5. Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen, me kontratë të veçantë në mes të kryetarit të komunës dhe Kompanisë "Qëndresa Gagica Hajdari B.1", e cila hartohet dhe nënshkruhet nga palet pas miratimit të Propozimi vendimit të Kryetarit në Kuvend dhe pas aprovimit të ligjshmërisë së vendimit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku pjesë përbërse do të jetë edhe Oferta e negociuar, plani i biznesit, plani dinamik dhe projekti i ideor, ndërkaq pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset, Kryetari i Komunës, DPGJK-ja, dhe DUPH-ja.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Kamenicë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr - 28/2008"), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi;
- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor;
- MAPL-së; dhe
- Arkivit



Xhevat Tafa

From: Driton Xhafa
Sent: Tuesday, July 16, 2024 10:27 AM
To: Liridon Kastrati
Cc: Xhevat Tafa; Erblin Hetemi
Subject: RE: Kërkesë për informata shtesë lidhur me dy vendime të datës 21.06.2024

I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës z. Liridon Kastrati,

Në emër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ju përshëndesë dhe në të njëjtën kohë ju informojmë se jemi në procedurë të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të kuvendit të komunës së Kamenicës . Bazuar në RREGULLORE (QRK) NR.06/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (QRK) NR.10/2019 PËR SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË AKTEVE TË KOMUNAVE neni 5 MAPL kërkon informata shtesë lidhur me tre vendime si vijon :

Dy (2) vendime Nr. 21061 dhe nr. 21059 për për dhënien e pronës së palaujtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë përmes procedurës së negociimit. Kërkesë e përbashkët dy vendimet është:

1. Referenca në dokumentin e planifikimit hapësinorë duke bere screen numerin e faqes dhe deshmia se eshte ne harmoni me PZHK ose Harten Zonale

Kërkesë specifike për vendimin 21061 është:

- Parcela kadastrale NR. 71107079-01212-0 e publikuar ne webfaqen zyrtare te komunës

Kërkesë specifike për vendimin 21059 është:

- Parcela kadastrale NR. 71107079-01372-0 e publikuar ne webfaqen zyrtare te komunës

Ju lutem që kërkesat e lartcekura t'i procedoni deri me se largu deri me datën 17.07.2024. Deri ne dërgimin e informatave te lartcekura pezullohet shqyrtimi i ligjshmërisë së vendimeve. Informatat plotësuese e dërguar nga komuna e Kamenicës e determinojnë shqyrtimin e ligjshmërisë. Për çdo informatë sqaruese jemi ne dispozicion e Juaj. Me te mira dhe suksese.

Me respect

Driton Xhafa- Zyrtar i Monitorimit të Komunave /MAPL
Fix; 64184 ose mobil 045-418-591
E-mail driton.xhafa@rks-gov.net